



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.30

19 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.244, datë 12.3.2009	Për ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar për zbatimin e Kodit Zgjedhor, në lidhje me kartat e identitetit, Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile dhe listat e zgjedhësve ...	1705
Vendim i BSH nr.5, datë 11.2.2009	Për miratimin e rregullores për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët	1706
Vendim i BSH nr.11, datë 25.2.2009	Për miratimin e rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”	1714
Udhëzim i KQZ nr.5, datë 12.3.2009	Për administrimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë	1736

VENDIM
Nr.244, datë 12.3.2009

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR ZBATIMIN E KODIT
ZGJEDHOR, NË LIDHJE ME KARTAT E IDENTITETIT, REGJISTRIN KOMBËTAR
ELEKTRONIK TË GJENDJES CIVILE DHE LISTAT E ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të neneve 77 pika 1 e 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni i posaçëm parlamentar për monitorimin e procesit të pajisjes së shtetasve me karta identiteti, të Regjistrin Kombëtar Elektronik të Gjendjes Civile, si dhe të punës paraprake për përgatitjen e listave të zgjedhësve.

II. Ky komision i posaçëm parlamentar ka për objekt monitorimin e përgatitjeve për infrastrukturën zgjedhore, në përputhje me Kodin Zgjedhor, për zgjedhjet e 28 qershorit 2009.

III. Komisioni i posaçëm parlamentar përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët 5 anëtarë i përkasin shumicës dhe 4 anëtarë opozitës.

IV. Komisioni përbëhet nga deputetët:

1. Ilir Rusmali	Kryetar	PD
2. Kastriot Islami	Zëvendëskryetar	PS
3. Fatos Hoxha	anëtar	PD
4. Osman Metalla	“	PD
5. Blendi Klosi	“	PS
6. Fatmir Xhafa	“	PS
7. Arjan Madhi	“	PR
8. Tritan Shehu	“	PDR
9. Albert Divjaka	“	PSD

V. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.5, datë 11.2.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR KREDINË KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE PËR INDIVIDËT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, të nenit 44 pika 4 të ligjit nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët” , sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**RREGULLORE
PËR KREDINË KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE PËR INDIVIDËT**

(Miratuar me vendimin nr. 5, datë 11.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së informacionit parakontraktor dhe kontraktor për kredimarrësin, përpara lidhjes dhe gjatë ekzekutimit të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individin, si dhe rregullimi i kredisë konsumatore.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e interesave të kredimarrësve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individin, nëpërmjet sigurimit të transparencës dhe pajisjes së tyre me informacionin e nevojshëm, për të kryer krahasueshmërinë e ofertave në treg.

**Neni 3
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe subjektet financiare jobanka që ushtrojnë veprimtarinë financiare të kredidhënies, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Këto subjekte në vijim për thjeshtësi, në këtë rregullore, do të quhen “banka”.

**Neni 4
Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, gërma "a" të ligjit nr.8269, datë

23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; të nenit 53, pikat 4 dhe 5, nenit 56, nenit 69, neneve 124 dhe 125 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", që më poshtë do të quhet ligji për bankat, dhe neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Neni 5 Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore. Termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) "normë efektive e interesit" – do të ketë të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 4 të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", miratuar me vendimin nr. 59, datë 29.08.2008, duke aplikuar njëkohësisht edhe përcaktimet e kësaj rregulloreje;

b) "normë e interesit" - është interesi i kredisë, i shprehur si një përqindje periodike fikse ose e ndryshueshme, e aplikuar për një periudhë të dhënë për vlerën e kredisë të vlefshme sipas kontratës së kredisë;

c) "konsumator" - do të ketë kuptimin e përcaktuar në pikën 6 të nenit 3 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve";

d) "kontratë/marrëveshje e kredisë konsumatore" – do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 44 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve";

e) "kontratë/marrëveshje e kredisë kufi (overdraft)" - është marrëveshja e kredisë konsumatore nëpërmjet të cilës banka i jep konsumatorit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij rrjedhëse, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari;

f) "kontratë/marrëveshje e kredisë për kartë krediti" - është marrëveshja e kredisë konsumatore sipas të cilës një bankë i jep ose premtos t'i japë kredi mbajtësit të kartës së kreditit për qëllime blerjeje ose tërheqjeje të parave cash, deri në një kufi të paracaktuar në kontratën e kredisë;

g) "kontratë/marrëveshje e kredisë hipotekare për individin" - është marrëveshja sipas të cilës një bankë i jep ose premtos t'i japë kredi një individ, e cila plotëson njëkohësisht karakteristikat e mëposhtme:

i) ka si objekt blerjen ose ndërtimin e plotë ose të pjesshëm të një prone të destinuar për banim (shtëpi, apartament); dhe

ii) kredimarrësi është blerësi ose poseduesi i kësaj prone të destinuar për banim.

KREU II INFORMACIONI PARAKONTRAKTOR DHE KONTRAKTOR

Neni 6 Informacioni parakontraktor

1. Banka i paraqet konsumatorit në formë të shkruar informacionin e duhur dhe kryesor, përpara lidhjes së kontratës së kredisë konsumatore, në mënyrë që ai të ketë njohuri të plota për transaksionin e lidhjes dhe ekzekutimit të kontratës, si dhe të ketë mundësi të zgjedhë ofertën më të leverdisshme në treg.

2. Informacioni parakontraktor përfshin:

a) vlerën totale të kredisë ose kufirin e kredisë në rastin e kredisë kufi (overdraftit) dhe/ose kartës së kredisë;

b) kushtet për lëvrimin dhe tërheqjen e kredisë;

c) kohëzgjatjen e kontratës së kredisë;

d) normën efektive të interesit nëpërmjet një shembulli përfaqësues dhe të dhënat financiare dhe supozimet e përdorura për llogaritjen e kësaj norme (sipas aneksit 2 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje), kur janë të aplikueshme;

e) normën e interesit dhe çdo indeks ose normë reference të aplikueshme mbi këtë normë interesi, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e saj;

f) vlerën e kështit, numrin e kështeve dhe periodicitetin e shlyerjeve të kështeve (pagesave), si dhe kur është e mundur të paraqitet një plan i shlyerjes së kredisë;

g) kushtet e përdorimit dhe të shlyerjes në rastin e kredisë kufi (overdraftit) ose kartës së kredisë;

h) mënyrën e njoftimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve të cilat sjellin pasoja për detyrimet pasurore të konsumatorit në bazë të kontratës;

i) koston e mbajtjes së një llogarie për kryerjen e transaksioneve të lëvrimit të kredisë dhe të pagesave, koston e përdorimit të një karte apo mjeti tjetër pagese për transaksionet e lëvrimit të kredisë dhe të pagesave, kosto të tjera lidhur me transaksionet e pagesave (kur është e aplikueshme);

j) çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë;

k) garancitë/kolateralin dhe sigurimin e kërkuar (kur është e aplikueshme);

l) ekzistencën e të drejtës së tërheqjes nga kontrata, periudhën gjatë të cilës mund të ushtrohet kjo e drejtë dhe procedurat për ushtrimin e kësaj të drejte;

m) të drejtën për të shlyer para afatit si dhe kostot që rrjedhin nga kjo (kur është e aplikueshme), duke treguar vlerën dhe metodën e llogaritjes;

n) kushtet penale dhe kamatëvonesat në rastin e pagesave që kryhen pasi u ka kaluar afati, siç janë të zbatueshme në kohën kur jepet ky informacion, si dhe penalitetet në rast të mosrespektimit të kushteve dhe/ose afateve të tjera të kontratës;

o) detyrimin për konsumatorin, në rastin kur në kontratën e kredisë kufi (overdraftit) parashikohet që kredia të shlyhet në çdo kohë me kërkesën e bankës, me një këst të vetëm ose brenda një afati tremujor, nëse është e aplikueshme;

p) kohën e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor për konsumatorin.

3. Banka i sugjeron konsumatorit, llojin dhe vlerën më të përshtatshme të kredisë, ndërmjet kredive që ajo ofron, duke marrë parasysh gjendjen financiare dhe/ose aftësinë paguese të konsumatorit, avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë produktin e propozuar dhe qëllimin e kredisë.

4. Banka, me kërkesë të konsumatorit, plotëson kërkesat e informacionit parakontraktor të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni si dhe jep shpjegime shtesë, me qëllim që konsumatori të jetë në gjendje të marrë vendimin e duhur.

5. Banka informon konsumatorin në rastin e mosmiratimit të kredisë konsumatore të shoqëruar me arsyet përkatëse.

6. Informacioni i treguar më lart duhet t'i vihet në dispozicion konsumatorit edhe në rastin kur ai hap një llogari rrjedhëse dhe ka të drejtë që të përdorë shuma më të mëdha se sa gjendja e kësaj llogarie, në formën e kredisë kufi (overdraftit).

Neni 7

Informacioni kontraktor

1. Kontrata e kredisë konsumatore përfshin elementet e mëposhtme:

a) qëllimin e kredisë;

b) të dhëna të plota për identitetin dhe adresat e palëve kontraktore;

c) vlerën totale të kredisë dhe kushtet për lëvrimin e saj;

d) afatin e maturimit të kredisë;

e) normën e interesit, kushtet që përcaktojnë mënyrën e zbatimit dhe përlllogaritjes së kësaj norme, çdo indeks ose normë reference të zbatueshme, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit, duke përcaktuar dhe mënyrën e njoftimit të konsumatorit për çdo ndryshim të mundshëm;

f) normën efektive të interesit dhe totalin e koston së kredisë për konsumatorin, të llogaritur në kohën që lidhet kjo kontratë kredie:

i) të dhënat financiare dhe të gjitha supozimet e përdorura për llogaritjen e kësaj norme,

ii) kushtet sipas të cilave mund të ndryshojë kjo normë, ose

iii) në rastet kur është objektivisht e pamundur të jepet norma efektive e interesit, konsumatorit i jepet informacion i mjaftueshëm në kontratën e shkruar për kostot/shpenzimet e kredisë;

g) çdo shpenzim që nuk përfshihet në llogaritjen e NEI-t, por që do të paguhet nga konsumatori në rrethana të caktuara duke treguar qëllimin si dhe vlerën në rastet kur është e njohur;

h) shumën e këstit, numrin dhe periodicitetin ose datat e çdo kësti (pagesave të konsumatorit) për të shlyer kredinë, dhe çdo shpenzim tjetër lidhur me dhënien dhe përdorimin e kredisë, të paraqitur në një plan shlyerjeje të kredisë;

i) koston e mbajtjes së një llogarie apo të përdorimit të një mjeti pagese për transaksionet e lëvrimit të kredisë dhe të shlyerjeve/pagesave, dhe kosto të tjera lidhur me transaksionet e pagesave (kur është e aplikueshme);

j) garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, dhe sigurimi i jetës ose

i pronës (kur janë të aplikueshme);

k) të drejtën e tërheqjes nga kontrata e kredisë, sipas përcaktimit të nenit 11 të kësaj rregulloreje;

l) të drejtën për shlyerjen e kredisë para afatit dhe të përfitimit të një reduktimi të kostos totale të kredisë;

m) kostot/penalitetet si dhe procedurat dhe metodologjinë e llogaritjes së tyre, të cilat konsumatori duhet t'i paguajë në rastin e shlyerjes së pjesshme ose të plotë të kredisë, përpara afatit të maturimit;

n) formën juridike të vendosjes së kolateralit, vlerësimin dhe mënyrën e vënies në ekzekutim të tij (kur është i aplikueshëm);

o) penalitetet lidhur me mosrespektimin e detyrimeve kontraktore të cilat nuk janë përfshirë në llogaritjen e normës efektive të interesit, por të cilat paguhen nga konsumatori në rrethana të caktuara si dhe përcaktimi i këtyre rrethanave. Në rast se njihet vlera e saktë e këtyre penaliteteve që në momentin e lidhjes së kontratës jepen shumat respektive dhe në rast të kundërt, jepet metoda e përlllogaritjes së tyre.

2. Në rastin e kredisë konsumatore e cila shlyhet me këste, si pjesë të kontratës ose si aneks të saj, banka paraqet edhe:

a) planin e shlyerjes së kredisë në momentin e dhënies së kredisë; dhe

b) mënyrën e llogaritjes së normës efektive të interesit (duke përfshirë në llogaritje të gjitha pagesat e paracaktuara që kredimarrësi paguan në momentin e marrjes së kredisë dhe gjatë gjithë kohëvazhdimin të saj) duke dhënë një shembull të detajuar.

3. Një bankë mund të përfshijë në kontratë me vullnetin e saj edhe informacion tjetër shtesë, përveç informacionit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 8

Kërkesa të përgjithshme mbi kontratat e kredisë

1. Kontratat e kredisë që përbëjnë objektin e kësaj rregulloreje bëhen në të gjitha rastet me shkrim dhe një kopje e kontratës së firmosur nga palët, i jepet personalisht konsumatorit në momentin e lidhjes së kontratës ose i dorëzohet apo dërgohet nga banka me postë të regjistruar në adresën e konsumatorit, brenda një periudhe prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga nënshkrimi i kontratës.

2. Në rastin e çdo kontrate garancie që siguron shlyerjen e detyrimit që lind nga kontrata kryesore e kredisë, kopje e kontratës së garancisë dhe e kontratës së kredisë i jepet edhe garantuesit të kredisë, në rast se ky i fundit është një person i ndryshëm nga kredimarrësi.

3. Një kontratë kredie konsumatore në çdo rast përcakton qartë kushtet e lëvrimin, qëllimin e përdorimit të kredisë si dhe kushtet dhe afatet e shlyerjes së kredisë, së bashku me penalitetet përkatëse.

4. Kontrata e kredisë konsumatore përmban një dispozitë të veçantë për periudhën që konsumatori ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Kërkesa të veçanta për kontratat e kredisë kufi (overdraft-i) dhe për kartë krediti

1. Një kontratë kredie kufi (overdraft-i) ose për kartë krediti përfshin informacionin e kërkuar sipas nenit 6, pika 2 e kësaj rregulloreje.

2. Konsumatori informohet rregullisht por jo më pak se një herë në vit për gjendjen e llogarisë së tij, nëpërmjet një dokumenti “gjendja e llogarisë” (statement of account) që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) periudha së cilës i përket gjendja e llogarisë (data e fillimit dhe data e fundit);

b) gjendja në fillim të periudhës;

c) vlerat/shumat, si dhe datat përkatëse kur kredia është vënë në dispozicion të konsumatorit me përshkrimin përkatës;

d) gjendja e llogarisë pas xhirimit të shumës/shumave të kredisë (bilanci i ri);

e) vlerat/shumat e pagesave dhe datat përkatëse kur janë kryer pagesat nga konsumatori, përshkrimi i veprimit/eve;

f) normën e fundit të interesit të rënë dakord;

g) çdo shpenzim/pagesë për interesat apo/dhe komisioni që është aplikuar, përshkrimi përkatës ;

h) gjendja e llogarisë në fund të periudhës.

2. Banka njofton konsumatorin gjatë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë, për ndryshimet në normën e interesit ose në kostot e pagueshme, siç përcaktohet në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

Neni 10

Kërkesa të veçanta për kontratën e kredisë hipotekare për individin

1. Në rastin e një individi që aplikon për kredi hipotekare, banka është e detyruar t'i paraqesë atij informacionin standard parakontraktor të plotësuar dhe personalizuar sipas formatit të dhënë në aneksin 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Në çdo kontratë kredie hipotekare për individin, banka plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje, me përjashtim të kërkesës së shkronjës "k" të këtij neni.

3. Banka publikon në ambientet e saj dhe pajis individin me informacion në formë të shkruar mbi mënyrën e përllogaritjes dhe/ose të ndryshimit të normës së interesit të kredisë hipotekare për individin, duke i ofruar klientit si një nga mënyrat e kuotimit të kredisë hipotekare, indeksimin e normës së interesit të kësaj të fundit me normën bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë për marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo).

KREU III

RREGULLIMI I KONTRATËS SË KREDISË KONSUMATORE

Neni 11

E drejta e tërheqjes nga kontrata/marrëveshja e kredisë konsumatore

1. Konsumatori ka të drejtën të tërhiqet nga marrëveshja dhe/ose kontrata e kredisë konsumatore pa dhënë ndonjë arsye për këtë qëllim, brenda një periudhe kalendarike 14 (katërmëdhjetë) ditore. Ky afat fillon nga dita e arritjes së marrëveshjes ose lidhjes së kontratës, ose nga data kur konsumatori merr dijeni për kushtet kontraktuale (nëse kjo e fundit është e mëvonshme).

2. Përpara ushtrimit të kësaj të drejte konsumatori njofton bankën për synimin e tij (brenda afatit prej 14 ditësh) për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë.

3. Në qoftë se kredia është disbursuar dhe përfituar nga konsumatori dhe në qoftë se ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata, banka njofton konsumatorin për vlerën e kredisë që duhet t'i rikthehet nga konsumatori. Kjo vlerë përbëhet nga shuma e kryegjësë dhe interesit për ditët përkatëse, si dhe shpenzimet e mundshme të bankës të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj kredie.

4. Shpenzimet e mundshme të bankës të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj kredie, përfshihen në çdo rast në informacionin kontraktor, ndërsa interesi llogaritet mbi bazën e normës së interesit të rënë dakord.

5. Nëse pala konsumatore përbëhet nga disa persona, dhe njëri prej tyre ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata e kredisë konsumatore, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, atëherë dhe personat e tjerë që përbëjnë palën konsumatore kanë të drejtën të tërhiqen nga kjo kontratë.

6. Nëse një konsumator tërhiqet nga kontrata e kredisë, edhe personi që ka hyrë në detyrime kontraktore duke dhënë garanci për detyrimet e konsumatorit sipas kësaj kontrate, mund të tërheqë gjithashtu garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kësaj kontrate.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet në rastin e shlyerjes (pagesës) së kredisë para afatit të maturimit

Konsumatori ka të drejtën e shlyerjes së plotë ose të pjesshme para afatit të maturimit të detyrimeve të tij, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e kredisë konsumatore për këtë qëllim. Në këtë rast, banka duhet të bëjë një reduktim të kostos totale të kredisë. Ky reduktim konsiston në uljen e interesave dhe kostove të aplikuara mbi pjesën e pashlyer të kredisë, për periudhën e mbetur sipas kontratës së kredisë.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Mbikëqyrja

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e

parashikuara në nenet 74 deri 80 dhe në nenin 89, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 14

Fusha e përbashkët e zbatimit

Kërkesat e përcaktuara në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr.59, datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës, zbatohen edhe për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individin, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

ANEKS 1

FLETË E STANDARDIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR PËR KREDINË HIPOTEKARE PËR INDIVIDIN

Zërat	Përshkimi
Teksti prezantues.	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk parasheh detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.
1. Banka.	
2. Qëllimi i produktit.	Qëllimi për të cilin akordohet kredia hipotekare për individin (blerjen ose ndërtimin e plotë ose të pjesshëm të një prone të destinuar për banim).
3. Përshkrimi i produktit.	Ky seksion duhet të japë një përshkrim të shkurtër, por të qartë të produktit. Duhet të shprehet qartë nëse si garanci do të përdoret një

	hipotekë mbi një pasuri ose garanci tjetër që përdoret zakonisht dhe nëse është i nevojshëm një vlerësim i kolateralit, dhe nëpërmjet kujt do të kryhet ky vlerësim. Po kështu në këtë seksion përshkruhet nëse produkti i ofruar parashikon pagesën (gjatë periudhës që zgjat kredia) e interesit dhe të kryegjësë me një pagesë të vetme në fund; dhe/ose nëse produkti parashikon pagesën si të kryegjësë dhe interesit gjatë gjithë periudhës së kredisë etj.. Gjithashtu, duhet të shprehet qartë nëse kushtet e kredisë hipotekare varen a) nga pagesa e një shume të caktuar nga konsumatori, e shprehur kjo si një përqindje e vlerës së objektit; dhe/ose b) nga një garanci e një pale të tretë.
4. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar).	Ky seksion duhet të japë informacion mbi kushtin kryesor të kredisë hipotekare për individin - normën e interesit. Përshkrimi duhet të përfshijë të dhëna a) se si do të ndryshojë norma e interesit duke konsideruar për shembull rishikimin e periudhave, mbylljet e tyre, çështjet që lidhen me penalitetet etj.; b) të dhëna mbi indeksimin e normës së interesit, qoftë e ndryshuar apo fikse, përkundrejt normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë (normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes); c) mënyrën dhe kohën e njoftimit për çdo ndryshim të normës së interesit.
5. Norma efektive e interesit.	
6. Vlera e kredisë dhe monedha në të cilën kërkohet.	
7. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë hipotekare (për shtëpi).	
8. Numri dhe frekuenca e pagesave.	
9. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë hipotekare.	
10. Tabela ilustrative e amortizimit të kredisë (plani i shlyerjeve).	Banka duhet të japë një tabelë përmbledhëse të amortizimit të kredisë e cila duhet të përmbajë të paktën: pagesat mujore ose tremujore sipas frekuencës (periodicitetit) të pagesave të përcaktuara në pikën 8 për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë; Tabela duhet të përmbajë të dhëna mbi: vlerën e kryegjësë së paguar; vlerën e interesit; kryegjënë e papaguar; vlerën e çdo kësti; shumën e kryegjësë dhe interesit. Duhet të shprehet qartë që kjo tabelë është vetëm një tabelë ilustruese dhe përmban një shënim nëse kredia hipotekare e propozuar mbart një normë interesi të ndryshueshme.
11. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin që aplikohen të tilla.	Duhet të paraqitet një listë e kostove të pakthyeshme të cilat duhet t'i paguajë konsumatori me marrjen e kredisë hipotekare. Kur këto kosto janë nën kontrollin direkt ose indirekt të bankës, duhet të jepet një vlerësim i tyre si dhe duhet të bëhet e qartë që këto kosto do të paguhet

	pavarësisht rezultatit të aplikimit për kredi. Kosto të tilla mund të përfshijnë për shembull: kostot administrative, komisionet ligjore, vlerësimin e pasurisë etj.. Duhet të shprehet qartë rasti kur një ofertë varet nga fakti nëse konsumatori do të pranojë që këto shërbime t'i kryhen nëpërmjet bankës.
12. Kosto shtesë të tjera.	Kjo listë duhet të përfshijë, për shembull: sigurimin ndaj mosplotësimit të pagesave (papunësi/vdekje); sigurimin ndaj zjarrit; sigurimin e ndërtesës dhe/ose të ambienteve shtesë. Duhet të shprehet qartë rasti kur një ofertë varet nga fakti nëse konsumatori do të pranojë që këto shërbime t'i kryhen nëpërmjet bankës.
13. Shlyerja para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme).	Banka duhet të shpjegojë: -kushtet e shlyerjes së parakohshme (nëse ka); dhe -shpenzimet e tjera që sjell kjo shlyerje. Kur nuk është e mundur të përcaktohen shpenzimet që në këtë moment, duhet të shprehet qartë që një shumë e tillë e mjaftueshme do të jetë e pagueshme për të kompensuar kostot e bankës për kryerjen e transaksioneve.
14. Skemat e brendshme të ankimit.	Emri, adresa dhe numri i telefonit të pikës së kontaktit për rastet e ankimit.
15. Penalitete të tjera.	Në këtë seksion jepet informacion mbi penalitetet që rrjedhin nga shkeljet e detyrimeve kontraktuale, të cilat nuk janë përfshirë në llogaritjen e NEI-t. Kur njihet vlera e saktë e tyre jepen shumat respektive dhe në rast të kundërt jepet metoda e llogaritjes.

ANEKS 2

DISA SUPOZIME MBI LLOGARITJEN E NEI-T PËR KREDITË KUFÏ (OVERDRAFTIN) DHE PËR KARTAT E KREDITIT

1. Nëse një kontratë kredie i jep të drejtën konsumatorit për të tërhequr fondet në çdo kohë, do të supozohet që vlera e kredisë tërhiqet menjëherë dhe në total.

2. Nëse një kontratë kredie parashikon mënyra të ndryshme tërheqjeje nëpërmjet aplikimit të komisioneve dhe normave të ndryshme të huamarrjes, do të supozohet që vlera totale e kredisë tërhiqet me komisionin më të madh dhe me normën më të lartë të interesit të zbatueshme për tërheqjen më të zakonshme të kësaj kontrate kredie.

3. Nëse një kontratë kredie i jep konsumatorit të drejtën e tërheqjes në përgjithësi të fondeve, dhe vendos midis mënyrave të ndryshme të tërheqjes një kufizim për shumën dhe periudhën e kohës, do të supozohet që shuma e kredisë tërhiqet në datën më të hershme të parashikuar në marrëveshje dhe në përputhje me limitet e tërheqjeve.

4. Nëse nuk ka një plan fiks pagesash, do të supozohet që:

- kredia që jepet për një periudhë njëvjeçare; dhe/ose
- kredia do të paguhet me 12 këste të barabarta mujore.

5. Nëse ka një plan fiks pagesash për shlyerjet, por shuma e pagesave është e ndryshueshme, do të supozohet që shuma e secilës pagesë është më e vogla nga vlerat që parashikon kontrata.

6. Me përjashtim të rasteve në të cilat është përcaktuar ndryshe, kur kontrata e kredisë parashikon më shumë se një datë shlyerjeje, do të supozohet që kredia bëhet e disponueshme dhe pagesat kryhen në datën më të hershme të parashikuar në kontratë.

7. Nëse në një kontratë kredie nuk është përcaktuar kufiri i saj, do të supozohet që ky kufi është 200,000 lekë ose kundërvlefë në monedhë të huaj.

8. Në rastin e kontratës për kredi kufi (overdraft), do të supozohet që kredia është tërhequr në total dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës së kredisë. Nëse nuk dihet kohëzgjatja e kontratës së kredisë, NEI do të llogaritet duke supozuar që kohëzgjatja e kredisë është tre muaj.

9. Nëse për një periudhë ose një shumë të kufizuar kredie ofron norma interesi dhe komisione të ndryshme, do të supozohet që norma e interesit dhe komisionet janë më të lartat për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë.

10. Në kontratat e kredisë konsumatore për të cilat është vendosur një normë fikse interesi në lidhje me periudhën fillestare, në fund të së cilës është vendosur një normë e re huamarrjeje dhe që më pas ndryshohet periodikisht sipas një indeksi të rënë dakord, llogaria e NEI-t do të bazohet në supozimin që, në fund të periudhës me normë fikse interesi, norma e interesit do të jetë e njëjtë si në momentin e llogaritjes së NEI-t, bazuar në vlerat e indekseve të rëna dakord në atë moment.

VENDIM

Nr. 11, datë 25.2.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për licencimin e subjekteve jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.96, datë 26.11.2003 dhe ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.88, datë 16.11.2005.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

RREGULLORE

PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA

(Miratuar me vendimin nr.11, datë 25.02.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:

a) licencimin e subjekteve financiare jobanka dhe institucioneve financiare të mikrokredisë për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë;

b) dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka

dhe të institucioneve të mikrokredisë;

c) detyrimet për njoftime në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka dhe institucioneve të mikrokredisë;

d) miratimin e agjentit të subjekteve financiare jobanka.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 1 pika 4 shkronja “b” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 126 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji për bankat.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë personat që kërkojnë të licencohen për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë, subjektet financiare jobanka dhe agjentët e tyre, si dhe institucionet financiare të mikrokredisë.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit për bankat kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

2. Termat e përkufizuar për bankat, në nenin 4, paragrafi “I”, pikat 23 dhe 24 të ligjit për bankat kanë të njëjtin kuptim edhe për subjektet e kësaj rregulloreje.

3. Përveç sa parashikohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “mikrokredi” - është kredia e lëvruar në shuma (vlera) jo më të mëdha se 600,000 (gjashtëqindmijë) lekë ose kundërvlefë e saj në valutë;

b) “institutacion financiar i mikrokredisë” - është subjekti financiar jobankë që plotëson njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i) ka si objekt të aktivitetit të tij vetëm kredidhënien dhe shërbimet këshilluese për veprimtarinë e kredidhënies,

ii) vlera mesatare e kredisë për një kredimarrës është jo më e madhe se vlera e mikrokredisë,

iii) të paktën 50 për qind e portofolit të kredisë përbëhet nga mikrokredi;

c) “agjent”- është personi juridik, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet për ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave, të përcaktuara në kontratën përkatëse të agjencisë me subjektin financiar jobankë, sipas parashikimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesave të kësaj rregulloreje;

d) “administrator” - është personi fizik sipas kuptimit të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KREU II

LICENCIMI

Neni 5

Autoriteti licencues dhe veprimtaritë financiare

1. Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për:

a) licencimin e subjekteve financiare jobanka për të ushtruar, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:

- i) të gjitha format e kredidhënies,
 - ii) faktoringun,
 - iii) qiranë financiare,
 - iv) shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave,
 - v) ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve,
 - vi) këmbimin valutor; dhe
 - vii) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara nga pika “i” deri te pika “vi”, të kësaj shkronje;
 - b) licencimin e institucionit financiar të mikrokredisë, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - c) miratimin e agentëve të subjekteve financiare jobanka.
2. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë/ve financiare lind vetëm pasi subjekti pajiset me licencë ose merr miratimin përkatës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6

Kërkesa për kapitalin

1. Shuma përkatëse e kapitalit fillestar minimal për t’u licencuar si subjekt financiar jobankë, është si më poshtë:
- a) për të gjitha format e kredidhënies,100,000,000 (njëqindmilionë) lekë;
 - b) për faktoringun.....20,000,000 (njëzetmilionë) lekë;
 - c) për qiranë financiare.....20,000,000 (njëzetmilionë) lekë;
 - d) për shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave20,000,000 (njëzetmilionë) lekë;
 - e) për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve20,000,000 (njëzetmilionë) lekë;
 - f) për këmbimi valutor.....1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;
- g) për shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara nga shkronja “a” deri te shkronja “f”, të kësaj pike10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.
2. Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionin financiar të mikrokredisë është 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë.
3. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për të ushtruar veprimtarinë financiare të transferimit të parave si agent i një subjekti jobankë është 1 (një) milion lekë.
4. Kapitali fillestar minimal i kërkuar për subjektet financiare jobanka që kërkojnë të kryejnë 2 (dy) ose më shumë veprimtari financiare nga ato të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë i barabartë me shumën që i përket nivelit më të lartë të kapitalit të kërkuar në pikën 1 të këtij neni, ndër veprimtaritë që subjekti financiar jobankë kërkon të licencohet.
5. Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal dhe çdo shtesë e mëvonshme e tij shoqërohen me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.
6. Banka e Shqipërisë ka të drejtë që të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin/et e krijimit të kontributeve/fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.
7. Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

Neni 7

Karakteristikat e licencës

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.
2. Licenca përfshin emrin tregtar të subjektit, aktivitetet për të cilat është licencuar, numrin dhe datën e lëshimit të saj.
3. Licenca e institucionit financiar të mikrokredisë përfshin përveç emrit tregtar të subjektit dhe emërtimin “institucion financiar mikrokredie”.

Neni 8

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për subjektin financiar jobankë dhe institucionin financiar të mikrokredisë

1. Kërkesa për licencim si subjekt financiar jobankë ose institucion financiar të mikrokredisë bëhet me shkrim nga themeluesit ose administratori i subjektit, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre.

2. Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) statuti i shoqërisë;
- b) akti i themelimit në rastin e një shoqërie të sapokrijuar;
- c) lista e themeluesve dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë;
- d) dokumenti i regjistrimit të subjektit si person juridik në regjistrin tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- e) ekstrakti nga regjistri tregtar për shoqërinë, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të për të cilën/at subjekti kërkon të licencohet;
- f) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për themeluesit, administratorin dhe/ose përfaqësuesin ligjor:
 - i. se personi nuk është në ndjekje penale;
 - ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
 - iii. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
 - iv. nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor, se personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankën e Shqipërisë;

- g) dokumentacioni për kapitalin dhe burimin e tij:
 - i. deklaratë noteriale të themeluesve se burimi i kapitalit fillestar të paguar të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë nuk është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta,
 - ii. deklaratë noteriale të themeluesve mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- për personat juridikë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për blerjen e aksioneve të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë) dhe certifikata e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna për bilancin e shoqërisë dhe rregullshmërinë e pagesës së tatimeve dhe taksave.

- për individët ose personat fizikë tregtarë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikata e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore; dhe

iii. vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 6, pika 1, 2 ose 3 sipas rastit. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

h) dokumentacioni për themeluesit në rastin kur themeluesit janë persona juridikë:

- i. statuti dhe ekstrakti i regjistrin tregtar (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj);
- ii. vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë;
- iii. vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale (për personat juridikë të huaj – aktet e barazvlefshme/ekuivalente juridikisht sipas legjislacionit/juridiksionit të huaj); dhe
- iv. në rastin e pjesëmarrjes influencuese dokumentacioni plotësohet me të dhënat për veprimtarinë tregtare dhe pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

i) dokumentacioni për themeluesit në rastin kur themeluesit janë persona fizikë tregtarë ose individë:

- i. për personat fizikë tregtarë:
ekstrakti i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale,
 - ii. për individët:
- dokumentin e identifikimit (emër, mbiemër, kombësia, shtetësia), adresa e saktë e vendbanimit dhe një CV e nënshkruar; dhe
- lista e bizneseve në të cilat themeluesi i subjektit financiar jobankë ka pjesëmarrje influencuese, ekstrakti i regjistrimit tregtar për secilin rast, si dhe të dhëna mbi ndonjë rast paafësie paguese dhe/ose falimentimi;
 - j) dokumentacioni për administratorin:
i) vendimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e tij;
ii) dokumentin e identifikimit;
iii) CV-ja e nënshkruar;
iv) diplomën universitare dhe dokumente që vërtetojnë kualifikimet e tjera të administratorit;
v) të paktën një referencë nga punëdhënësi të mëparshëm; dhe
vi) deklaratë personale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.
 - k) planbiznesin e propozuar me përmbajtje si më poshtë:
i. struktura e organizimit të shoqërisë;
ii. veprimtaritë financiare që parashikon të kryejë, vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
 - iii. parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë së tij pas licencimit, pasqyrat financiare;
 - iv. burimet e financimit dhe struktura e aktiveve për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë pas licencimit ;
v. parimet, në bazë të të cilave është përgatitur plani i biznesit;
 - vi. një informacion, sipas formularit 6 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, lidhur me mjediset ku subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë parashikon të kryejë veprimtarinë/të; dhe
 - vii. një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj.) për 3 (tre) vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë.
 - l) aktet e brendshme rregullative të miratuara nga organet vendimmarrëse (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme për sistemin e kontrollit të brendshëm, për transparencën me klientin (mbrojtjen e konsumatorit), për administrimin e rrezikut të kredisë, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit etj.).
3. Dokumentacioni sipas pikës 2 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.
4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 9

Kërkesa për administratorët

1. Administratorët e subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë, duhet të plotësojnë të paktën kriteret e mëposhtme:
- a) të kenë diplomë universitare, si rregull në ekonomi ose jurisprudencë;
 - b) të kenë përvojë profesionale jo me pak se 3 (tre) vjet në fushën financiare ose bankare ose në ndonjë fushë tjetër të konsideruar të përshtatshme nga Banka e Shqipërisë;
 - c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional;
 - d) të mos kenë shkaktuar ose të mos kenë qenë përgjegjës për falimentimin e ndonjë subjekti që ushtron aktivitet ekonomik;
 - e) të mos jenë në ndjekje penale ose të mos jenë shpallur fajtorë nga gjykata për një vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;
 - f) të mos kenë qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafësisë paguese ose falimentimit, si dhe të jenë të çliuar nga pagesa e detyrimeve pasurore të kaluara;

g) të mos jenë ndëshkuar nga Banka e Shqipërisë gjatë 5 (pesë) vjetëve të fundit për shkelje të rëndë të ligjit për bankat ose për zhvillim të veprimtarisë pa licencën përkatëse të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 10

Kriteret për dhënien ose refuzimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë merr vendim për dhënien e licencës vetëm kur krijon bindjen se subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket kushteve të mëposhtme:

a) themeluesit e subjektit kanë reputacion të mirë, burim të ligjshëm të kontributeve në kapital, veprimtari të ligjshme, të regjistruar dhe që mund të mbikëqyret, kanë mundësi financiare për derdhjen e fondeve shtesë në qoftë se kapitali bie nën nivelin minimal të kërkuar nga Banka e Shqipërisë ose për realizimin e financimeve të nevojshme për vazhdimin e qëndrueshëm në kohë të veprimtarisë së subjektit;

b) kualifikimet, përvoja e reputacioni i administratorit dhe i themeluesve me pjesëmarrje influencuese janë të përshtatshme për realizimin e planit të biznesit, në bazë të të cilit ato licencohen;

c) strukturat operationale dhe të kontrollit, përfshirë politikat dhe procedurat e subjektit financiar jobankë ose të institucionit financiar të mikrokredisë, reflektojnë qëllimin dhe shkallën e plotësimit të veprimtarive të propozuara për t'u kryer prej tyre;

d) plani i biznesit i paraqitur është real dhe konkurrues në treg, dhe gjendja e pritshme financiare e subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë të propozuar është e kënaqshme.

2. Banka e Shqipërisë refuzon dhënien e licencës kur nuk plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, sidomos në rastet e mëposhtme:

a) nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

b) të paktën njëri nga administratorët ose themeluesit me pjesëmarrje influencuese ka qenë subjekt i procedurave të deklarimit të paafësisë paguese ose falimentimit;

c) nuk paraqitet informacion lidhur me identitetin e themeluesve me pjesëmarrje influencuese;

d) vërtetohet se të paktën njëri nga themeluesit:

i. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore;

ii. është në ndjekje penale ose është dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizimit, dhe

iii. kur ndaj tij është marrë vendimi nga gjykata për moslejimin e ushtrimit të profesionit;

e) nuk plotësohet informacioni shtesë i kërkuar nga Banka e Shqipërisë, sipas nenit 11 pika 3 të kësaj rregulloreje;

f) nuk posedon shumën e kapitalit fillestar minimal, të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari financiare.

3. Banka e Shqipërisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i njofton subjektin vendimin për dhënien e licencës ose e njofton atë me shkrim mbi refuzimin e dhënies së saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

Neni 11

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon dhënien e licencës si subjekt financiar jobankë ose si institucion mikrokredie, brenda 2 (dy) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë.

3. Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuessit, nga Banka e Shqipërisë.

4. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune do të dërgojë një njoftim për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e kësaj rregulloreje, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

5. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencë Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.

6. Banka e Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas kërkesave të parashikuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje, si dhe pas plotësimit të informacionit shtesë sipas pikës 3 të këtij neni:

- a) shqyrton dhe analizon dokumentacionin e paraqitur;
- b) vlerëson aftësinë profesionale të administratorëve;
- c) organizon nëse e çmon të nevojshme takime me administratorët e subjektit financiar jobankë ose institucionit të mikrokredisë për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar të subjektit.

7. Banka e Shqipërisë mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria financiare, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e këtyre veprimtarive, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 12

Publikimi dhe botimi i vendimit për dhënien e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë ose institucion financiar i mikrokredisë.

2. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare.

3. Banka e Shqipërisë regjistron të dhëna në regjistrin e subjekteve financiare jobanka lidhur me agjentët e këtyre të fundit.

Neni 13

Komisionet

1. Subjekti që kërkon dhënien e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë ose institucion financiar i mikrokredisë paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë prej 30,000 (tridhjetëmijë) lekësh në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni, i përcaktuar në këtë nen, nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 14

Pezullimi ose revokimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë mund të pezullojë ose të revokojë licencën e subjektit financiar jobankë ose të institucionit financiar të mikrokredisë në rast se:

- a) kërkohet nga vetë subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë i licencuar;
- b) ekzistojnë të dhëna të besueshme se themeluesit ose administratorët janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;

- c) ka shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë ka pësuar një humbje të ndjeshme financiare ose ka filluar procesin e falimentimit;

- d) subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë nuk ekzekuton urdhrat për ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje, si dhe ndreqjen e shkeljeve të dispozitave ligjore dhe nënligjore;

- e) ka shkelje të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe si rezultat nuk arrihet të përcaktohet gjendja financiare e subjektit;

- f) subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë pengon, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, përmbushjen e funksionit mbikëqyrës nga Banka e Shqipërisë;

- g) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht nëse është dhënë nga subjekti apo ka të bëjë me subjektin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të themeluesve me pjesëmarrje influencuese të propozuar, ose parregullsi të tjera për

fakte të rëndësishme që lidhen me shqyrtimin e kërkesës për licencë;

- h) nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;
- i) nuk fillon veprimtarinë brenda 3 (tre) muajve nga marrja e licencës ose ndërpret ushtrimin e veprimtarisë për më shumë se 3 (tre) muaj;
- j) subjekti ka pushuar së ekzistuari si person juridik;
- k) institucioni financiar i mikrokredisë nuk plotëson më kriteret e kësaj rregulloreje për t'u karakterizuar si i tillë, për një periudhë prej jo më pak se 3 (tre) muajsh.

2. Vendimi për pezullimin ose i revokimin e licencës i komunikohet menjëherë me shkrim, subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë, ku jepen dhe arsyet.

3. Vendimi i pezullimit ose revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

4. Subjekti ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në licencën e tij pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për revokimin e saj, ose për aq kohë sa zgjat shkaku apo afati i pezullimit.

Neni 15

Publikimi dhe botimi i vendimit për pezullimin ose revokimin e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për pezullimin ose revokimin e licencës për të vepruar si subjekt financiar jobankë ose institucion financiar i mikrokredisë.

2. Vendimi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një ose më shumë gazeta kombëtare.

NËNKREU I

Neni 16

Miratimet paraprake

1. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, nuk mund:

- a) të ushtrojë veprimtari financiare të papërfshira në licencën e dhënë;
- b) të zvogëlojë kapitalin;
- c) të emërojë një ose disa administratorë;
- d) të transferojë pronësinë e një ortaku ose aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose kontrollin e subjektit.

2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 2 (dy) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, për të marrë miratimet paraprake të parashikuara në shkronjat b), c) dhe d) të nenit 16 të kësaj rregulloreje, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) për zvogëlimin e kapitalit:
 - i. vendimin e asamblesë për zvogëlimin e kapitalit; dhe
 - ii. relacionin shoqërues me arsyet e këtij ndryshimi.
- b) për të emëruar administratorin/ët:
 - i. vendimin e strukturës vendimmarrëse për emërimin e administratorit/ëve,
 - ii. dokumentacionin sipas shkronjës “j”, të pikës 2, të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
- c) për transferimin e pronësisë së një ortaku ose aksioneri me pjesëmarrje influencuese ose për transferimin e kontrollit të subjektit:
 - i. vendimin e asamblesë për miratimin e këtij ndryshimi;
 - ii. dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 2, shkronjat “e”, “f”, “g” “h” dhe “i” të kësaj rregulloreje; dhe

iii. kopje të aktmarrëveshjes së nënshkruar për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit të subjektit.

2. Banka e Shqipërisë sipas rastit mund të kërkojë edhe dokumente shtesë përveç sa është parashikuar në këtë nen.

NËNKREU II

Neni 18

Veprimtaritë shtesë

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, subjekti financiar jobankë ka të drejtë t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë, të lejohet të kryejë veprimtari të tjera financiare, të përfshira në licencën e dhënë, duke plotësuar kërkesat e nenit 6 dhe nenit 19 të kësaj rregulloreje.

Neni 19

Dokumentacioni për miratimin e veprimtarisë shtesë

1. Kërkesa për të ushtruar veprimtari shtesë, bëhet me shkrim nga administratori i subjektit ose një person i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë shtesë;

b) ekstrakti i Regjistrimit Tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria/të shtesë në objektin e shoqërisë;

c) dokumenti që vërteton pagimin e shtesës së shumës të kapitalit fillestar minimal, në qoftë se kapitali i llogaritur nuk plotëson kërkesën për kapital për veprimtarinë që kërkon të kryejë ky subjekt, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje;

d) informacioni mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë, sipas rregullores “Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”, për kryerjen e veprimtarisë shtesë, në rast se kjo e fundit është veprimtari me sportel;

e) rregulloret dhe/ose manualët e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë shtesë;

f) parashikimin për 3 (tre) vitet e ardhshme të treguesve financiarë për veprimtarinë/të shtesë, dhe ndikimin e tyre në gjendjen e përgjithshme financiare të subjektit.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 20

Shqyrtimi i kërkesës për veprimtari shtesë

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e plotësimit të kërkesës për kapital dhe dokumentacionit për ushtrimin e veprimtarive financiare shtesë, në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 19 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 2 (dy) muajve pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë, jep miratimin për kryerjen e veprimtarive shtesë nëse vlerëson se këto veprimtari nuk vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të subjektit financiar jobankë dhe plotësohen kushtet teknike për ushtrimin e sigurtë të tyre.

3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për të ushtruar veprimtari shtesë, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

NËNKREU III

Neni 21

Kërkesat mbi detyrimet për njoftim

1. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në rastet kur:

- a) pozicionet e rrezikut arrijnë kufijtë maksimalë të lejuar të ekspozimit, sipas akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë;
- b) vlerësohet se ka shkaqe të justifikuara për ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë veprimtarie financiare të lejuar;
- c) vlerësohet se ka shkaqe për revokimin e licencës;
- d) kur institucioni financiar i mikrokredisë gjatë veprimtarisë së tij nuk plotëson më të paktën një nga karakteristikat e përcaktuara në nenin 4, paragrafi 3, shkronja “b” të kësaj rregulloreje.

2. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve për:

- a) ndryshimin e emrit;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) zmadhimin e kapitalit;
- d) ndryshimet në strukturën e kapitalit aksioner që nuk janë subjekt i miratimit paraprak sipas kësaj rregulloreje;
- e) ndryshime në strukturën organizative;
- f) hapjen ose mbylljen e degëve të subjektit apo ndryshime të adresës së tyre;
- g) ndryshim të selisë dhe adresës së tij apo të selisë dhe adresës së agjentëve të subjektit financiar jobankë;
- h) largimin e administratorëve; dhe
- i) çdo ndryshim tjetër që është i detyrueshëm për regjistrim në regjistrin tregtar.

KREU III

MIRATIMI I AGJENTIT

Neni 22

Veprimtaritë financiare të agjentit

1. Subjekti financiar jobankë, mund të ushtrojë veprimtarinë financiare të transferimit të parave nëpërmjet një ose më shumë agjentëve.

2. Agjenti për ushtrimin e veprimtarisë financiare të transferimit të parave merr miratimin e Bankës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë mbikëqyr agjentët në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së transferimit të parave.

Neni 23

Dokumentacioni për miratimin e agjentit

1. Kërkesa për miratimin e agjentit për të ushtruar veprimtarinë financiare të transferimit të parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë, bëhet me shkrim nga administratori i agjentit ose një person i autorizuar ligjërisht prej tij dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) dokumentacioni me të dhënat identifikuese për agjentin, si më poshtë:
 - i. statuti i shoqërisë;
 - ii. akti i themelimit në rastin e një shoqërie të sapokrijuar;

- iii. dokumenti i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si person juridik;
- iv. ekstrakti i Regjistrimit Tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria të cilën/ agjenti kërkon të ushtrojë; dhe
- v. dokumenti se nuk është në procedurë likuidimi apo falimentimi;

b) kontrata e agjencisë, e lidhur ndërmjet agjentit dhe subjektit financiar jobankë, ku të jenë shprehur të drejtat dhe detyrimet respektive në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë financiare;

c) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për themeluesit dhe administratorin e agjentit:

- i. se personi nuk është në ndjekje penale;
- ii. se personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- iii. se personi nuk është i dënuar penalisht; dhe
- iv. se personi nuk është në procedurë ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në Bankën e Shqipërisë;

d) informacion mbi mjediset dhe kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë financiare;

e) informacion mbi mënyrën e regjistrimit dhe ruajtjes në një regjistër të posaçëm të të gjitha transaksioneve të transferimit të parave në ushtrimin e veprimtarisë që kryen në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë;

f) vërtetimi nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas nenit 6, pika 3 të kësaj rregulloreje. Kjo shumë, zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

2. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni të jetë dhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

3. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 24

Shqyrtimi i kërkesës për miratimin e agjentit

1. Banka e Shqipërisë bën shqyrtimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura lidhur me kërkesën për licencim të agjentit, në përputhje me kërkesat e nenit 23 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, brenda 1 (një) muaji pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë sipas nenit 23 dhe plotësimit të kërkesës për kapital sipas pikës 3 të nenit 6 të kësaj rregulloreje, jep ose refuzon miratimin për agjentin për të ushtruar veprimtarinë financiare të transferimit të parave.

3. Në rastin e refuzimit të kërkesës për miratimin e agjentit, Banka e Shqipërisë jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 25

Revokimi i miratimit të agjentit

1. Banka e Shqipërisë revokon miratimin e agjentit të subjektit financiar jobankë në rast se:

- a) kërkohet nga vetë agjenti ose subjekti financiar jobankë;
- b) agjenti është përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;
- c) subjektit financiar jobankë i është revokuar licenca, ose i është pezulluar apo ndërprerë e drejta për të ushtruar transferimin e parave;
- d) agjenti ushtron veprimtari të tjera financiare përveç transferimit të parave, për të cilat nuk është i licencuar;
- e) agjenti nuk ka aftësi paguese ose ndaj tij ka filluar procesi i falimentimit;
- f) kontrata ndërmjet agjentit dhe subjektit financiar jobankë është zgjidhur ose është e pavlefshme;
- g) agjenti ose subjekti financiar jobankë nuk ekzistojnë më si persona juridikë ose kanë humbur zotësinë për të vepruar;

h) agjenti, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve, pengon ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë;

i) miratimi është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë ose të pasaktë, që lidhet me shqyrtimin e kërkesës për miratim;

j) nuk përmblush më kushtet në bazë të të cilave ai është miratuar;

k) nuk fillon veprimtarinë brenda 3 (tre) muajve nga marrja e miratimit ose ndërpret ushtrimin e veprimtarisë për më tepër se 3 (tre) muaj;

l) për çdo shkak tjetër që vlerësohet si i tillë nga Banka e Shqipërisë.

2. Agjenti dhe/ose subjekti financiar jobankë detyrohen të njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për faktet dhe/ose rrethanat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Vendimi për revokimin e miratimit i komunikohet menjëherë me shkrim agjentit dhe subjektit financiar jobankë ku jepen dhe arsyet.

4. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Të tjera

1. Të gjitha shoqëritë tregtare që kërkojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre, duke kryer edhe një ose disa nga veprimtaritë e përshkuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtë të paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin përkatës për licencim.

2. Për shoqëritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shuma e kapitalit fillestar minimal në lidhje me veprimtaritë e parashikuara në nenin 5 që subjekti parashikon të kryejë, do të konsiderohet kapitali i llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Bankës së Shqipërisë për mbikëqyrjen e subjekteve financiare jobanka, me të dhënat e certifikuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

3. Subjektet financiare jobanka, në rast të plotësimit të karakteristikave të institucionit financiar të mikrokredisë të përcaktuara në këtë rregullore, kanë të drejtë të kërkojnë të licencohen si institucione financiare të mikrokredisë, në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë rregullore. Banka e Shqipërisë kur licencën subjektin si institucion financiar të mikrokredisë, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si subjekt financiar jobankë.

Neni 27

Dispozitë kalimtare

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen të licencuara sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, në përputhje me aktivitetet financiare të përcaktuara në licencën ekzistuese.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'u kërkojë subjekteve të licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, informacione shtesë nëse vlerëson se informacioni i paraqitur në kohën e marrjes së licencës nuk është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

3. Për kërkesat e paraqitura në Bankën e Shqipërisë për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtari financiare përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje dhe që u përkasin subjekteve të cilave u është komunikuar me shkrim nga Banka e Shqipërisë se kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja nr. 96, datë 26.11.2003 "Për licencimin e subjekteve jobanka" e ndryshuar, do të zbatohen dispozitat e kësaj të fundit

4. Për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e këmbimit valutor si zyra të këmbimit valutor, do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat e rregullores "Për licencimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor", miratuar me vendimin nr.31 datë 06.06.2007 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

5. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë financiare të transferimit të parave në emër dhe për llogari

të subjekteve financiare jobanka, duhet të paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë kërkesën për miratimin e tyre si agjent, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 28
Të fundit

Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Fatos Ibrahim

**KËRKESË
PËR
BANKËN E SHQIPËRISË
LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TË DHËNË LICENCË
PËR SUBJEKT FINANCIAR JOBANKË / INSTITUCION FINANCIAR MIKROKREDIE**

Emri i subjektit : _____
Vendndodhje e propozuar : Adresa _____, Shqipëri
(Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si subjekt financiar jobankë / institucion financiar mikrokredie.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të legjislacionit shqiptar.

Kërkuesit

P.s. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

**Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi “Skënderbej” Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.**

VENDIMI

I -----
(ORGANIT VENDIMMARRËS)
PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

----- (Organi vendimmarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, ----- (organi vendimmarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

(Emri) (Atësia) (Mbiemri)

Adresa: _____
(Rruga, Numri) (Qyteti) (Shteti)

(Numri i telefonit) (Numri i faksit/teleksit)

Përfaqësuesi i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e ----- (organit vendimmarrës). Përfaqësuesi është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë .

Datë _____,

(Emri mbiemri)

(Nënshkrimi)

Shënim : Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(të realizuara nga veprimtaria financiare)

PARAQITET PËR 3 VITET E PARA TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT

TOTALI I TË ARDHURAVE _____ Lekë

SHPENZIMET

TOTALI I SHPENZIMEVE _____ Lekë

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE _____ Lekë

ADMINISTRATORËT

Emri i subjektit financiar jobankë / institucionit financiar të mikrokredisë:

Emri e mbiemri i administratorit	Adresa e banimit të administratorit	Detyra	Numri i kuotave që zotëron në kapital ¹	Përqindja ndaj totalit
TOTALI				

¹ Në qoftë se zotëron.

CERTIFIKATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve, pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në këtë ditë _____

të _____, 20 ____.

(Nënshkrimi i noterit publik)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në origjinal!)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

_____ data _____, 20 _____

KY DOKUME ËSHT I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ _____

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË: _____

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firmë, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data/muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

_____ data _____, 20 _____

KY DOKUMENT ËSHTË I VLEFSHËM PËR 6 MUAJ

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

MJEDISET E SUBJEKTIT DHE VENDNDODHJA E TIJ ²

1. Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit:
 - Vendet e përhershme marrë me qira.
 - Vendet e përhershme pronë vetiake.
 - Vendet e përkohshme.
2. Përshkrimi i mjediseve:
 - a) Mjediset që do të merren me qira:
 - i) kostoja vjetore e parashikuar e qirasë së subjektit financiar jobankë;
 - ii) përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të parashikuara të ndërtesës.
 - b) Mjediset në pronësi:
 - i) emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së lokalit (objektit);
 - ii) kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.
 - c) Vendet e përkohshme:
 - i) vendndodhja e mjediseve të përkohshme;
 - ii) detaje lidhur me mjediset e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë;
 - iii) në qoftë se mjediset e përkohshme do të blihen, parashikimin e kostos, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes;
 - iv) në qoftë se mjediset e përkohshme do të merren me qira, të jepet parashikimi i vlerës së qirasë mujore.
3. Investimi i propozuar në mobilje, në pajisje dhe një përshkrim të sendeve.
4. Investimi i propozuar për të pëmbushur kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

² Shënim: Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.

INFORMACION PËR THEMELUESIT E SHOQËRISË

[illegible]

PLANI I VEPRIMTARISË SË PROPOZUAR

Plani i veprimtarisë duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të subjektit. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht gjatë vitit të parë të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht për sa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve. Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet pasur kujdes për përgatitjen e planit të veprimtarisë.

Në planin e veprimtarisë:

1. Prezantohet struktura e organizimit të shoqërisë.
2. Përshkruhen politikat e subjektit për veprimtaritë që kërkon të kryejë, objektivat dhe pozicionin i tij në treg.
3. Përshkruhen veprimtaritë, segmenti i tregut (klientela), produktet dhe shërbimet që propozon të kryejë gjatë 3 (tre) viteve të para të veprimtarisë.
4. Përshkruhen burimet e financimit dhe struktura e aktiveve për 3 (tre) vitet e para të aktivitetit. Tregohet deri në çfarë shkalle subjekti jobankë do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua, jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet financiare.
5. Përshkruhen vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij.
6. Përshkruhet parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për 3 (tre) vitet e para pas licencimit të veprimtarisë së tij, pasqyrat financiare.
7. Prezantohet një informacion, sipas formularit 6 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, lidhur me mjediset ku subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë parashikon të kryejë veprimtarin/të.
8. Prezantohet një parashikim në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës (tregues të kujdesit, raporte etj.) për 3 (tre) vitet e ardhshëm.

Organi vendimmarrës duhet të shqyrtojë, të diskutojë dhe të miratojë kushtet e planit që mendohet të jetë me përfitim. Plani i biznesit mendohet të jetë një paraqitje e planeve dhe e parashikimeve të menduara prej organit vendimmarrës, për të qenë të arritshme dhe Banka e Shqipërisë mund të mbështetet në të, gjatë shqyrtimit për miratimin ose jo të kërkesës.

UDHËZIM
Nr.5, datë 12.3.2009

**PËR ADMINISTRIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN NË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 99, nenit 100, nenit 115, nenit 116, neni 122, pika 4 dhe nenit 138 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për përgatitjen dhe administrimin e materialeve zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në komisionin zonal të administrimit zgjedhor (KZAZ), në komisionin e qendrës së votimit (KQV) dhe ndërmjet tyre, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Në kuptim të këtij udhëzmi, materiale zgjedhore quhen të gjitha materialet të cilat do të përdoren nga administrata zgjedhore në funksion të procesit zgjedhor.
2. Materialet zgjedhore grupohen në dokumentacion zgjedhor, materiale zgjedhore të inventarizuara dhe materiale të përgjithshme zgjedhore.

Neni 3
Struktura përgjegjëse

1. Materialet zgjedhore përgatiten nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, në bashkëpunim me pjesën tjetër të administratës së KQZ-së, sipas procedurave që përcakton ky udhëzim dhe aktet e tjera të KQZ-së.
2. Materialet zgjedhore merren në dorëzim nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, në përputhje me aktet e KQZ-së.

PJESA II
PËRGATITJA E MATERIALEVE ZGJEDHORE PËR FILLIMIN
E PUNËS SË KZAZ-SË

Neni 4
Materialet zgjedhore për fillimin e punës së KZAZ-ve

1. Pas ngritjes së komisioneve zonale të administrimit zgjedhor (KZAZ), Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore përgatit materialet zgjedhore për fillimin e punës së KZAZ-ve. Dorëzimi i materialeve zgjedhore bëhet në KZAZ me procesverbal model: PV – KZAZ – 01. Transporti i materialeve zgjedhore për fillimin e punës për KZAZ-të, bëhet nga administrata e KQZ.
2. Skema e transportit dhe dorëzimit përgatitet nga Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore, dhe u njoftohet menjëherë anëtarëve të KQZ-së.
3. Materialet zgjedhore për fillimin e punës të KZAZ-së, të përgatitura sipas pikës 1 të këtij neni, i dorëzohen si rregull KZAZ-së.

Neni 5

Materialet zgjedhore që shërbejnë për informim dhe edukim

Materialet zgjedhore që shërbejnë për informim dhe edukim, u dorëzohen zyrove rajonale Zgjedhore, në çdo qark. Inspektorët Rajonalë marrin masat për dorëzimin në KZAZ, të artikujve promociionalë, sipas grafikut të shpërndarjes të dërguar nga KQZ-ja.

PJESA III

PËRGATITJA E MATERIALEVE ZGJEDHORE PËR KZAZ-TË, GN-TË DHE KQV-TË

Neni 6

Materialet zgjedhore për KZAZ-të

1. Materialet e inventarizuara dhe dokumentacioni zgjedhor merren në dorëzim nga KZAZ-ja me procesverbal model: PV - KZAZ – 02.

2. Materialet e përgjithshme zgjedhore organizohen në një paketë të vetme të mbyllur, të cilat dorëzohen në KZAZ. Lista e materialeve që ndodhen brenda paketës verifikohet sipas inventarit vetëm pas hapjes së saj.

3. Të gjitha materialet zgjedhore për çdo KZAZ paketohen në kuti të veçanta ambalazhi, në të cilat shënohet emri i KZAZ-së përkatëse.

Neni 7

Materialet zgjedhore për GN-të

Materialet zgjedhore për grupet e numërimit përfshihen në kutinë e materialeve të KZAZ-së. Materialet që i dërgohen KZAZ-së për grupet e numërimit përcaktohen sipas një inventari bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 8

Materialet zgjedhore për KQV-të

1. Materialet zgjedhore për çdo KQV paketohen në kuti të veçanta ambalazhi, ku përfshihet kutia e votimit, kutia e materialeve zgjedhore dhe kanë të shënuar numurin e ZAZ-së dhe numrin e QV-së.

2. Materialet e përgjithshme zgjedhore organizohen në një paketë të vetme të mbyllur, brenda së cilës futet lista e detajuar (inventar) e materialeve që ndodhen brenda paketës.

3. Kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore do të jenë të identifikueshme me etiketa të veçanta.

PJESA IV

DORËZIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 9

Mënyra e shpërndarjes së materialeve zgjedhore

1. Skema e shpërndarjes së materialeve zgjedhore përgatitet nga Drejtoria e Logjistikës dhe i njoftohet anëtarëve të KQZ-së.

2. Materialet zgjedhore shoqërohen në çdo KZAZ nga një punonjës i KQZ-së. Punonjësi i KQZ-së merr në dorëzim materialet zgjedhore për komisionet zonale të administrimit zgjedhor e përkatës, sipas skemës së shpërndarjes.

3. Punonjësi i KQZ-së merr në dorëzim nga DLZ materialet zgjedhore me procesverbalet sipas modeleve dhe specifikimeve të përcaktuar në lidhjet përkatëse bashkëlidhur këtij udhëzimi, si më poshtë:

a) PV - KZAZ - 02 , për materialet zgjedhore për KZAZ-në

- b) PV - KZAZ – 03, për materialet zgjedhore për KQV-të;
- c) PV – KZAZ - 04, për fletët e votimit.

Neni 10

Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KZAZ

1. Materialet zgjedhore për KZAZ-në, GN-të dhe KQV-të i dorëzohen si rregull kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KZAZ-së. Në rastet të mungesës së tyre të zëvendësohen me anëtarët që i përkasin të njëjtit spektër politik.

2. Në momentin që KZAZ merr në dorëzim materialet zgjedhore, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari, në prezencë të KZAZ-së, hapin në fillim kutinë e materialeve zgjedhore për KZAZ-në dhe verifikojnë listën e inventarit bashkëlidhur procesverbalit që ndodhet brenda kutisë për KZAZ-në.

PJESA V

ADMINISTRIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KZAZ-JA

Neni 11

Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja, për KQV-të

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZAZ-së, bëjnë dorëzimin e materialeve zgjedhore për çdo KQV, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 100 të Kodit Zgjedhor.

2. Materialet zgjedhore për çdo KQV merren në dorëzim nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KQV-së, sipas procesverbalit model PV- KQV-05, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Çdo anëtar i KQV-së që dëshiron, mund të jetë prezent.

3. Vulat metalike me kodet e sigurisë për kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore i dorëzohen KQV-së me procesverbalin model PV-KQV-06, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kryetari i KQV-së, me zgjedhje rastësore, merr vulën e kryetarit të KQV-së, gris ambalazhin e vulës dhe pasi vulos modelin krahasues të vulës në një fletë të bardhë shënon emër, mbiemër dhe firmos në prani të anëtarëve të KZAZ-së.

Neni 12

Marrja në dorëzim e kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja pas mbylljes së votimit

1. Pas mbylljes së procesit të votimit, KZAZ-ja organizon në vendin e numërimit të votave grupet e pritjes së kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore me jo më pak se 2 anëtarë të saj, me përkatësi të kundërt politike.

2. Gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, grupi i marrjes në dorëzim në fillim merr dhe verifikon kutitë me fletët e votimit dhe ndjek këto procedura:

a) Shënon në procesverbalin e marrjes në dorëzim, model PV - KZAZ- 09, numrat e kodeve të sigurisë, me të cilat është mbyllur kutia e votimit.

b) Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave, me të cilat është mbyllur kutia e votimit, sipas procesverbalit të dorëzimit të kodeve të sigurisë: PV – KZAZ - 06, të mbajtur nga KZAZ-ja për këtë qendër votimi.

c) Në rast se gjatë marrjes në dorëzim të kutisë së votimit, grupi i marrjes në dorëzim konstaton se:

- mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode të sigurisë;
- vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë të tillë që lejon ndërhyrje ndërmjet kutisë dhe kapakut të saj;
- kutia ka në trupin ose në kapakun e saj thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit ose materiali tjetër të votimit;
- kutia është e ndryshme nga lloji, forma dhe përmasat e miratuara dhe dërguara nga KQZ-ja, atëherë grupi i marrjes në dorëzim shënon në PV-në e marrjes në dorëzim parregullsinë e

konstatuar, sipas pikave “a”, “b”, “c” dhe informon menjëherë KZAZ-në dhe i kërkon asaj të bëjë vlerësimin e kutisë.

d) KZAZ-ja, pasi vlerëson rastin, merr vendim, i cili shënohet në procesverbalin e konstatimit. Nëse kutia vlerësohet e parregullt, asaj i vendoset etiketa “KUTI E PARREGULLT”. Nëse kutia vlerësohet si e rregullt, grupi i marrjes në dorëzim vazhdon më tej procesin.

e) KZAZ-ja shënon mospërputhjet e konstatuara në procesverbalin e marrjes në dorëzim PV – KZAZ – 09, bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe në librin e protokollit.

3. Kutia e vlerësuar si e parregullt, vendoset në vendin e veçantë të caktuar për “KUTITË E PARREGULLTA”, dhe nuk i nënshtrohet procedurave të numërimit nga grupi i numërimit të votave.

4. Kutitë e votimit të vlerësuara si “KUTI TË PARREGULLTA”, në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk merren më në shqyrtim dhe nuk hapen nga KZAZ-ja.

5. Në rastet kur kutia e materialeve zgjedhore vlerësohet si “E PARREGULLT”, atëherë ajo u nënshtrohet procedurave të përcaktuara në nenin 115 të Kodit Zgjedhor.

6. Procesverbali i marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja, PV- KZAZ -09, firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari i KQV-së. Punonjësi i policisë firmos në këtë procesverbal vetëm për shoqërimin, garantimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga qendra e votimit në vendin e numërimit të votave.

7. Procesverbali hartohet në 4 kopje, një kopje e procesverbalit të marrjes në dorëzim PV- KZAZ-09, i jepet KQV-së, një kopje i dorëzohet policit shoqërues, një kopje dorëzohet në KQZ, kurse kopja origjinale administrohet nga KZAZ-ja.

8. Nëse gjykohet e nevojshme, KZAZ-ja mund të caktojë 2 persona për çdo grup, në ndihmë të grupit për marrjen në dorëzim të kutive, të cilat meren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Personeli ndihmës zgjidhet nga lista e antarëve të grupeve të numërimit të votave, duke garantuar në çdo rast barazpeshën politike shumicë-opozitë. Kutia/kutitë me fletët e votimit dhe kutia/kutitë me materialet e votimit merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në vendin e numërimit të votave, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.

PJESA VI

PRITJA E DOKUMENTACIONIT DHE E MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KQZ

Neni 13

Dorëzimi i tabelave të rezultateve, kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore

1. Menjëherë pas përfundimit të procedurave të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i KZAZ-së dorëzon në KQZ tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, model 40-09 dhe tabelat origjinale të rezultateve të qendrave të votimit model 57-09, procesverbalin e marrjes në dorëzim të KZAZ-së, procesverbalin e konstatimit, librin e protokollit të mbledhjeve, vulën e KZAZ-së, kutitë e votimit me fletët e votimit, kutitë e materialeve zgjedhore, materialet zgjedhore të inventarizuara, si dhe çdo dokument tjetër zgjedhor.

2. KQZ-ja, organizon grupet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore me jo më pak se 2 persona të administratës së KQZ-së të autorizuar nga titullari i institucionit.

3. Dorëzimi i materialeve zgjedhore të inventarizuara bëhet me procesverbal KZAZ- PV- 11, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore dorëzohen me procesverbal model PV – KZAZ- 13, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, së bashku me tabelat e rezultateve të qendrave të votimit, procesverbalin e marrjes në dorëzim të KZAZ-së, procesverbalit të konstatimit, librit të protokollit dhe vula e KZAZ-së dorëzohen veçmas me procesverbal PV-KZAZ–12, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Tabelat origjinale përmbledhëse të rezultateve, tabelat e rezultateve të Qendrave të votimit, libri i protokollit, procesverbali i konstatimit, si dhe kopjet origjinale të procesverbaleve të dorëzimit të tyre në KQZ, depozitohen në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumentacionit.

Neni 14

Administrimi i kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, në rast të hetimit administrativ në KQZ

Në rast se, për nevoja të hetimit administrativ, kutitë e votimit apo të materialeve zgjedhore hapen, rimbyllja e tyre bëhet me anë të procesverbalit PV-KQZ-14, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Ky proces verbal mbahet në një kopje dhe i bashkëngjitet vendimit të KQZ.

Neni 15

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.3.2009
Doli nga shtypi më 19.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë